SI SHENIE NDÉRIMI PER JÉTE

ZOTIT

GÉG POSTRIPPE

Vjérshetorit tone Kombitar

Dhuronj kete libre

LULO MALSORI

BKSH

ВКSH

GHAKU

PAMJ' É PARE

Ne qimitir, kudo varrė, ca mė kryqė, ca mė shtylle te tjėra vėtem mė plloçe. Mbi nje var te bukur mė shtylle te mėrmėrte falėt Dhora, mbi nje tjėter prane saj falėt Lipi.

DHORA

Ketu te çlodhén koskat i vdékur ketu jé
O! ti qe nuku njoha qe jétene me dhé

Fytyren te mérmérte fati me ben te shoh
Ty qe zoti ne botte nuku me la te njoh

O! ngréu nga varri àte sé nuku kam njéri
Ne botte te me doje ngréu te me duash ti

Ngréu si çupat é tjéra dhê û baba te kém
Sé véteme mé tyne fatmire munt te jem

Kur shoh réth méjé shoqé mé nene mé
(baba
Lotét reké me véne qe s'jam dhé û si ta
Ngréu! psé me lé te vétem? te véteme ç'
(me lé?
O! ngéu nga ghum'i jétes, pa dashure ku ré.
Té tjére ne kte verse shkojne jéten
(mé gas
Po une vétem fillja dite nate, pelcas
Se qari un' é mjéra, se qajturi né vaj
Sé njezét vjét u beshe dhé kaq kohe zi mbaj
S' pashe nje dit te bardhe, dit te mire
(s' kam par
S' kam qéshure nje dite qe kur ti jé ne var
Nenen s' é njoha faré, tyne faré s'te njoh
U riçe pé te huaj hédhur nga-do kudô
Si é varfer qe isha si é varfer qe jam
Dite te bardhe s' njoha. Vétem ne botte jam
Pa nene, ate, moter, unq, émte a vella
Pa njéres pa te dashur vdékja joté me la
Pa shoqé te me duan pa miqé, pa njéri
Jétene témé shkova dhé shkonj ne hidheri
Po vall' éné do ngase kjo jéte kesi soj?
O! Zoti mos é dhente sé me nuku durroj

O! Zoti mos é dhente te ronj' éné mbi dhê
Po vdékjen me dergofte kete botte te lé

T' ikinj, dhé û mé jyvé te bashkoném atjé
Ku jini te dy bashke mé nenene ku jé

Me late te pa ritur, me lat' ne foshnjeri
Te m' shihni sa jam ndruar, sa jam ritur (tani

O vdékje! éja mérme sé me nuku ronj dot
Shpetome nga kio jéte, nga botta q' esht' (é kot'

(Unj koken hélmuar dhé zé te qanje héshtur)

LIPI (Aferohét mé te madhé te sjélle)

Me ndjé kudzimne zonje qétimne qe te (prish
Po kam qe kur se largu qe po te shoh te (rish

Mbe ghunjezaj lotuar te qash mbi kete var
Pra arçe te te lutém qe te pushosh se qar'

DHORA (hidhur)

Zot

LIPI

Di sé ç' do me thuash, qe loti ka çdefrim
Ghithe sa jan hélmuar kete kane méjtim

Po jo, sé kot do qajne, kot do te hédhin lot
Me kot do te vajtojne, i vdékuri s' vjén dot

Ngréu Zonje dhe fshi syte, pusho! mos qaj pusho
Sé syte do te prishesh dhé s' ben gheséndi jo

DHORA

Si te mos qanj é mjéra? vétem ne botte jam
Pa ate, nene, moter, fis, fare nuku kam

LIPI

O! ndjénj plagen é thélle qe ti ne zémmer ké
Po é par' a é fundit moj zonje nuku je

DHORA

O! nu bésonj ne botte, o! nuk' bésonj (jo! jo!
Te kéte tjéter çupe te héqe ter' keto

LIPI

Kam pare dhé te tjéra

BKSH

DHORA

O jo! si mua s' ka
Te lindéte pa nene, te ritét pa baba
Dhé mjér ajy ne botte, nje mie hére mjér,
Qe prindete s' k'a prane

LIPI

Kam pare dhé te tjer
Te riténe pa nene, te ritén pa baba

DHORA

O jo or Zot! si mua tjéter ne botte s' ka
Nenen m' a vravi mjéku atjé ku pillté mû
(Me mir' t' mos isha pjélle)

(Refën varre)

dh' im' ât' q' eshte ketu
Pé plumbi eshte vrare, u vra n' armiqesi.
S' isha dy vjéç q' at' héré, kam mbétur pa njéri
Pra, si do kéte tjéter si mua mbi kte dhé
Dy plage qe te kéte?

BKSH

LIPI

Zonje te dréjte ké
Po ndjéme si ihuaj te t' pyés ghér me sot
Ghakn' é âtit é moré?

DHORA

Jo! ghaku i roth kot!

LIPI *(hidhur)*

Dh' éné ri dyké qare? dh' éné mbi var lotton?
S' te vjén n' hender jyt âte? si, ghakne s'te kerkon?

DHORA

Shum'hére é kam pare, ghakosur ghithenje
Te m' thote: bia imé pé ty kerkonj nje ghe

LIPI

Ghakne kerkon i mjéri

DHORA

Po kush é vrau nuk di

BKSH

Sé kur u vra me muar, me shpunè ne
(Vllahi
Me ritne n' dhê te huaj, ku s' eshte ky zakon

LIPI

Po ketu qè kur ardhé psé vrasesin s'kerkon?

DHORA

Nuk jam dhé kaq fajtoré sé, véteme qe djé
M' é beri ras i Nalti dhé shkéla ne kte dhé

LIPI

Mir po tani qe ardhé, qe prane varrit ri
Kerko te msosh armikne

DHORA

Do vé fuqin' é mi
Dhe s' ri ghakne pa mare, mbi kete var
(benj bé

LIPI

Tani vertéta Zonje Shqiptarké zémmer kè
Pra lére tani lotét, mos qaj dhe mos vajto

BKSH

Po véteme per ghakne qe sot é tutjé ro
Dhé po te duash Zonje dhé ù munt te te ndih
Mé sa te munt i mjéri.

DHORA

T' u nghat jéta zotni

LIPI

Tani dhé nje koshille per mé te dhene kam
Mbaj arme kurdo héré

DHORA

É armatosur jam
(Duké qitur nga mézinje koburé q' i refén)
Kur arçe per ketéja nghésha kete ne brés
Pa vdékure im émte, me thiri, tha: «do vdés
» Dhé do te mbétésh véte o! Dhore pa njéri
» Po na kete kobure, kete fis fare ki
» Kete me la jyt âte, i mjéri im vella
» Kur te benéte Dhora ne verse jépja tha
» Pra, sot qe jé é vétem qe s'ké as fis as far
» Na shok per jétekié dhékur te vésh mbi var
» Té qash atjé tet âte nghéshur ne brés é ki
» Te t'shohe te gezonét, i vdékur shpirt' i ti»

LIPI

Po kur te dha koburén psé zonje nuk te tha
Kush é ka vrar tet àte?

DHORA

Sé vdékja nuk é la
Atjé ku keto théshté atjé é mjéra shoj

LIPI

Te pakene psé émrin te vrasesit s'te shkroj?

DHORA

Te shkruanje nuk dinté
(Ne funt te varrèvé dukét nje plake)
po ja nje plake vjén
Kjo munt te na lajmonje sé, zémra imé
(ndjén
Q' é afermé do jéte dita qe ghak do mar
Dita, te çlodhén koskat te babese ne var
O! zot ner ment ç' me sollé, ne zémmere
(ç' me dhé
Me t' mirin gas ne botte, shprésen me t'
(mir mbi dhé

BKSH

LIPI

Detyre zonje kisha kete keshill' te t' ap
Po lér keto me nj'ane, te pyéç plaken çap

DHORA

Me ndjé to vété

LIPI

Èce ! Une te prés ketu
Mundét te késh névoje per no nje ghe
(nga mû

DHORA

Si do çperblénj no nj' hére ty zot ket
(miresi ?

LIPI

Lére keto te lutém, çap pyét mé ndziti
Te msosh émrin t' armikut édhé nje or
(me par
T' i çlodhéne tit ati koskat é tî ne var

DHORA

Me ndjé

BKSH

LIPI

Shko shekо punen

(Dhora hiqét ne funt te qimitirit prane plakes)

LIPI (*véte*)

O çupeze é mjér!
Ne lulé t'jétes tendé te rosh ne zi ne tmér
Dhé vrasesé te behésh pa dashure dhé ti
T' u shkrua ne te trétat te mbyllesh nje (shtepi
T' eshte shkruar te Iyésh duart é tu ne ghak
Nga syri t' hédhesh loté zémra te t'hédhe (flak
Dhé njezét vjét t' u shkrua mé loté, vaj te (shkosh
Sé ne hélmé u lindé dhé ne hélmé do rosh
O! Pérendi ç' é beré mé kaq fatkéqesi?
Ç' é berré qe te ronje mé loté dhé mé zi?
Valle ç' faj te ka berre pa lindure, o zot!
Te shkonje jéten terre é hélmuar mé lot?
O Pérendi i larte! o zot qe jé ne qéll!
Valle fajne te prindvé mbi koke te saj (sjéll

(pas nje hështje)

Por eshte zémmer forte, zémren pa tutur ka
Pé ghe s' i tutét syri

(Dhora afrohét é hélmuar)

DHORA

Èmrin é tî m' é tha
Esht' i pasur, i mire, mé çupa djém te ri
Po plak miékere zbardhur, shtadhjéte vjéç
(njéri
Dhé me vjén kéq te vritét pé duarte te mi

LIPI

Beju burre moj Zonje, zémmer te forte ki

DHORA *(mé ashke)*

O! zémmer kam te forte dhe ghak ne
(rembat kam
Te flakte, nuku tutém sé *Shqipetaré* jam

LIPI

Te lumte! nuk pandéhnja kaq zémmer
(çupé ré

BKSH

DHORA

Te thashe jam Shqiptaré

LIPI

Vertét Shqiptaré jé!
Dhé ndér'i Shqipetarés moj zonje t'urdheron
Armikne tent te vrasesh sa-dô q'é
(meshiron

DHORA

Do t'é vras te jap fjale mbi kete var benj bé
I ghalle te mos mbése armiku tém mbi dhé
Po me ndjé nje te mire téjé kerkonj zotni

LIPI

Fole Zonje pa frike fjalen t'ap qe tani
Te te ndih mé ç'me mundét ne ket te
(shenjte pun

DHORA

Te me refésh armikne njérine qe s' njoh ùn,

LIPI

Po ku t' é di i mjéri?

BKSH

DHORA

Un' èmrin te te thém
Koli Ripa i thone.
LIPI *(dykė hėdhur mė nje hére)*
Pérendi! babaj jém!
(mbėtén te dy si te mahnitur)

PÉRDIA BIÉ

BKSH

PAMJ' É DYTE

(Anes nje pylli. Prapa nje shèlgu math eshte fshèhur Dhora mè marti nen mbi sup. Zghat koken dhè si shèh qe ruga esht' è shkrète, dèl.)

DHORA *(vètem)*

Msova ketéj do shkonje dhé pa durrim é
(prés
T'i mar ghakn'è tim äti, ghak palar te
(mos jés
Kam nje muaj tanine q'é ruanje kudô
Po s'munt t'é ghénj ghekundi, sado
kerkonj sado
Ne shtepi ri, me thane, i mplakur nuk
(dél dot
Dh'é bia po t'mos pillté nuk do délté as
(sot,
Imjéri, té é bia shkon l'uronje mé gas
Dhé ku te die q'une é prés ketu t'é vras?
T'é vras! persé? Ç'ka bere? tem àte paska
(vra?
Po ç' mé kete? im àte s'i pat vrare
(vella?

Dhé i vellaj nuk shtriti tem unq ghall'é
(mbe dhè?
O botte genjéshtaré! keshtu peshtire jé
Zakoné!..... égersirat nuk vrasine keshtu
Si vrasim né pa prére si vrasim né ketu.
Ne ju ndés ghaku njerit, a n'eshte nje i lik
Shtepi duhét te shuhét mé t'aferme mé
(mik
Te tjéret s'jane njéres n'Europe ne Vllahi?
Po jo, ata jan njéres né jémi égersi!
Égersi ne ghak déhur, é lakmuar per ghak
Sé vrasim, thérrim, présim pa meshiruar
(pak!
Ghétke vrasesin marin é véne ne burghi,
É'ghykojne, é mvarin.....po né ne
(Shqiperi?
Ghakne marim mé dorè dh' é kémi
(trimeri
Te léme gra te Véja, te mbyllime shtepi
Femiene te léme te varfer pa babà
Nena pa djém te vétem dhé motra pa
(vella.
O! zakon i peshtire qe mishrate me dréth!
kur kujtonj qe tanine ghak pé plaku do
(héth

Dhé mjékr'é ti é bardhe, dhé trup'i ti dy kaç
Nuk do me meshirojne sé duhéte t'é (vraç
Zakon i vendit thote dhé mé kete zakon
Behésh pa dashur vrases sé ndryshé (nuku ron
O! zakon' i peshtire! barbarizmi zakon
Qe ne ghak na ké lidhur dhé qe ghakne (na mson
Qe n'végheli, qe fosbnja mé ghak na tunt (ne djép
Dhé qe, te varfer nena mé ghak sise na (jép
Per ty zakon i poshte, i felliqur zakon
Te vritéte i biri é emma é dergon
Per ty vellaj vellane dhé âti bire vrét
Per ty i biri t'atne, t'é vrase, ruges prét
Sa ghér me sot jan'vrare, sa jan thérur (ghér sot
Sa sy per ty kan'qare, sa nena dérdhur lot
Sa motra kan'vajtuar, sa kane mbajtur zi,
Dhé po t' mos shuhésh tine nuk do (mbétét njéri
Poshte zakon i tmérur! zakon qe s'ngopésh (ghak
Nuk do te beném vrases! per tyne s'vras nje plak

(Hėth martinen)

Te vras? vrases te beném? pa dashure
(dhé û
Te pi ghak pé nje plaku? étja per ghak
(me zu?
O! jo jo! nuku dua! o! jo! jo! nuku vras!
Shpirtin tém ne skétére nuku dua te
(kllas!
E kthjélle ghér sot rojta dh'é kthjélle do
(te ronj
Edhé zakon é tmérur nuk dua te sherbonj
(Ne funt te ruges dukén kater njéres)
Ja ku vine me dukét, ja, ja, ku po afron;
Dh'im âte qe nga varri ghakn'é tî me kerkon
(Pas nje pushim te vogel, mé hidherim)
Hiqu méjtim i tmérur, hiqu méjtim i kéq,
Sé, te vras plakn'é mjére pé zémré me vjén
(kéq
(Madheshtoré)
Po jo, nje ze me thote: «E pa bése do jésh
Dhé mallekimn'é âtit nga varri do te késh
Armikne po t'mos vrasesh qe tet âte pat
(vrà
S'eshte y qe te varfer foshnje pa àt te la!

Ky eshte qe terr'jéten ne hidheri te shtiu?
Ky este qe pé foshnje jétene tendé ndziu
Ky eshte! dhé te ghalle tine tani é lé?
O nuku behét kurre! duhét t'é shtrinj per
(dhê!

(Unjèt mèr martinen. Plaku, Lipi dhé te dy shèrbetoret afrohèn Fshihèt)

(Dyshmuar)

T'i bié keti plaku? po mekat nuku kam
Dhé mjékrene te bardhe t' i ndéronj? po
(jo! s'jam
As é par'as é fundit qe nje plak do te vras
Kur mé vrasjen im âte ne var do ndjénje
(gas

(Sikur i flét'éres) –

Gezoju ât'i mjére dhé uraten me jép
Sé te dergonj armikne qe na ndau qe ne
(djép

(Ngré martinen)

Oh! t'é vras a t'mos é vras, as une nuku di
Te shtrinj per dhê armikne? te vras kete
(te zi
Do mos é vras! po, ghaku i tim âti qe do
Te lahéte nga ghaku? mja meshironj! sa dô

Do t' é vras! édhé Zoti do me ndjénje
(pastaj
Sé dhé n'é vras pa dashur, nga shpirti po
(é qaj

(*Dél dhé qéndron mé arme te ngritur ne més te ruges*).

Prit atjé Kole Ripa! tim âti çap ju fal
Sé tî me varferové dhé û s'te lé te ghall

(*Çkré armen, Kola bié*)

U lavé ghak i âtit! u mbushé o zakon!
O vrasese u vravé! Kole Ripa me s' ron!

(*Te dy shérbetoret sulén te zéne Dhoren. Lipi ngré t'âtne te plagosur dhé kujt i rjédhin ghakrat nga ghoksi*).

KOLA (*shérbetorevé*)

Mos é trazoni faré, sillni ketu t'é shoh
Ket zémmere te madhé per s'afermi te njoh

DHORA (*gezuar*)

Ron! o Zot te jam fale.

KOLA *embel si i vété Dhora, prane*)

Moj bie ku te di?
Ç' te lige te kam bere qe tî me ben pu sî?
E para hér te pashe.

DHORA

kini te dréjte Zot,
Dhé une s'ju kam pare é para hére sot
Qe, ju shoh, édhé àti ne ghak me pati shty
Sé njezét vjét perpara im àt' u vra pé ty
Èdhé zakon i vendit pa dashure na shtyn
Tine të vraç tem âte dhé une te vras tyn'
O! ndjéme ne fajtova dhé ne mos mbajta (ndér
Po dukéte qe fati per vrasje me ka (lér'
Si njéri, kerkonj ndjése qe bera ket kudzim
Si bia, qe s'te vrava ne zémmer kam (hidhnim
Sé koskat' é tim àti do dridhéne ne var
Dyké kujtuar prape qe mbéçe ghak palar
Po,un bera detyren dhé do t' é benj éné
Sé te vritésh pé méjé nga fati shkruar ké
Dhé me vjén kéq mé zémmer, nga shpirti (me vjén kéq
Po fati me ka shkruar dy plumba te te héq
Kete zakon jy kini kete dhé une kam
Dhé mé zakon é tmérur lidhur per vrasje (jam
Po tani qe me kini ner duarte ketu
Mos me lini te ghalle sé néser ju vras ù

KOLA (*si i habitur*)

Kam nj' ore q'i mahnitur po te deghonj
(te flaç,
Qe déshé te me vrasesh dhé prap do te
(me vraç
Po te te deghonj mahnitur, çuditure deghonj
Sé kurre nuku prisnja nje çupe te shekonj
Mé zémmere si tyne mé tendéne fuqi
Te flase é pa tmérur mb' udhe te zér pusî

DHORA (*hidhur*)

Fuqia kot me vaté; pusine zura kot
Sé te te vras kam dale dhé nuk te vrava
(dot

KOLA (*mallenghyér*)

O! çupez é pa tmérur qe tutjé nuku njéh
Detyren ti é beré dhé plumbin mir é dhé
Lavé ghakn'é tit áti é gezové ne var
Detyren tendé beré nuku jé per te shar
Ne ghoksit drejt me hoqé dhé faj nuku
(ké jo!
Sé Shpirtin i lésové po, te vdés Zoti s' do

Nuku jė ghak palare mė kuqė trimeri
Plumbin m'ė dhė shum mire mbushė zakon
(ė zi.
Degho moj bia imė mua plakne deghô
Te te thėm nje ĸeshille kur Pėrendia s'do
Nje ĸomp te perparonje çarjen ne mės
(dergon
Dhė ku 'shte dashuria, armiqesine shton
Dhė i vėrbon te terre, vellaj-vellane
(s'shėh
I âti s'njėh te bire, i biri t' âtne s' njėh,
Dhė vritėn pa meshire dhė vritėne pa
(shĸak
Sė s' ngopėne se vrari, sė s'ngopėne mė ghak
Ç'ĸėmi nė ne mės tene as tî as une s'dî
Por une vras tet âte dhė mua me vrėt tî
Persė as nė nuĸ dime as qe pyėsim nė
Te msojme ç'eshte shkaku po dxėtene me lė
Une te lashe tyne dhė tine djalit tėm
Dhė shuhėne pa ditur, burra. gra ėdhė
(djėm.

DHORA (*hidhur*)

Dhė û ketô méjtohėm mė zėmrė hėlmesi
Po si te bejme ndryshė q'eshte zakon
(i zi ?

Po te mos maresh ghakne, te thone ghak
(pa-lar
Dhé qe te maresh ghakne duhét te çosh
(ne var
Duhét te behésh vrasesh, te behéshe i lik
Sé kur jé ghak-palare nuku ké shok as mik

LIPI

Duhét zakoni hédhur, leftuar ky zakon

DHORA

Nuk munt sé ghak-palare njéri ketu
(nuk ron

KOLA

Nuku kam patur frike, s'tutém ne pléqeri
Po dua te lanj ghakne!

LIPI (*çuditur*)

Te vraç Zonjen do ti

KOLA

Jo oré bir sé ndryshé munt te lahét nje
(ghak
Munt te lahét pa dérdhur as faré pike
(ghak?

BKSH

Pra po te bejne terre si (qésh) do te bejme
(né
Do te prishét zakoni.

LIPI (*buzeqéshur*)

Ç'méjtim ò àte ké?

KOLA

Degho ketu moj bie, degho ketu or bir
Njériu duhét te ronje ne kete dhé i lir
Tyne si çupe dasha, dhé tyne bir te kam
Dhé sot q'u mqlakçe, une per n'ate bote jam
Dhé plumbi te mos vinté, vdékja do venj'
(vétiu
Nuk do te ronj sa rojta, per jéte s'ron
(njériu
Po dua sa pa vdékur ty djale te martonj
Zémrene témé plake pa vdékur te gezonj
Pra, me te mire çupe, mé zémmere vertét,
Mé ment édhé te sjélla dhé qe sat
(emmé nghét
Véç Zonjes s'pashe tjéter

(*Dhores*)

Po te duash dhé tî
Hajdé ghakne te lajme dyké bere krushqi

(*I hèq pran'è prane*)

Afrohi ketu prane, afrohi t'u mblésonj
(I vé te zihén dore per dorè dhé dyké ju vene duarte mbi koke).
Per jét u trashegofshi, nga zémra ju uronj

Bié Pérdja

BKSH

PAMJ'É TRÉTE

Hod'é Koles nje hode plàku T' atyrè visévè. Kola i smure rende, i shtrire ne shtrat.

KOLA (*vète*)

Tani édhé ne vdéksha i gezuar do shkonj
Sé si martova djalen, me téper s'kam te (ronj,
I pashe te bashkuar, i pashe te dy tok
Ne lidhje te martéses kurorene mbi kok
Dhé shpirti m'u defryé, dhé zémra m'u (gezu!
Pra lé te rojn'uruar, per tà lé te vdés û
Po prape nuku désha qe tanine te vdés
Ne zi te shtié nusén ne te gazite més
Po bottese ç'i thua? kohes qe rojme né?
Fatkéqesi, pikllimé, hélmé, mundimé ké,
S'munt te rosh i gezuar, fatmire nuku ron
Atjé ku jé kenaqur nje plump ghoksit (te shkon
Persé? nuk di as tine as qe vrasesi di
Persé? sé zakon' eshte ketu ne Shqiperi

Nusja te vrase vjére édhé vellaj vella
l âti vrét te bire, i biri vrét babâ
Ghaku, te thone, ghaku! o fjale plot mé tmér!
I déh si égersirat, mente nga koka mér
Sé vrava u la ghaku? sé u vrashe u la?
Jo! me téper u shtua sé ghak me téper ra!
Dhé me téper do rithté te vritéshim éné
O zakon i tméruar! lidhur ne ghak na ké

(Pas nje pushim te vogel)

Po vdés, dhé vdékja imé sa do te qahét sa
Sa do te qanje nusja qe plumbine me (dhâ
Po mos déshté é mjéra. te me vrase (dh'ajo?
Te me vrase nuk déshte jo! nuku déshté jo
Po zakoni é lidhi ajy é pàti shtyr
Ajy é armatosi dh'i tha: «vraj ket te ndyr
»Qe tet âte pat vrare dhé mos pyét persé
»Sé qe te vraç armikne detyr te shenjte (ké»
Dh' ajo me vrét fortsuar Ah zakon ! ah (zakon !
Ligesia te polli, ligesia te shton

(Bié me krahezaj, pas nje pushim hyn Dhora)

DHORA

Si u gdhivé sot àte? nuk jé me mire sot?
O! Korba une, pika!

KOLA

Pusho! mos fole kot!
Ku' shte Lipi? psé s'ardhi?

DHORA

Tani do vinje tha
Po s'me thé, si u gdhivé? o! pika qe
(s'me ra

KOLA

Pusho sé jam me mire, u sheruash tanî?
Ashtu me paç uratat ném ca uje te pi

DHORA

Un te te sjéll *(Dél)*

KOLA *(véte)*

O bie! zémre margaritar!
Pas pak do mbétésh véte sé une zbrés ne
(var

BKSH

Dhé te méjtoném pake qe tin'atjé me çon
Qe te sherbésh te poshtin, te felliqur zakon

(Hyn Lipi prapa tî Dhora)

LIPI

Si jé âte

KOLA

Me mire, po tî or bir si jé

LIPI

Mos me shih mua âte

KOLA

Po per mua kéq ké?

DHORA

Na ujene

KOLA

O bie! uratáte me ĸi
Ketu dhé n'ate bote é uruare ji!
(*Hyne Marga mé Tasen*)
Hajni ketu moj bia, hajni ketu dhé jy
Rini ketu pran méjé t'ju shoh te terr'
(mé sy

Te bashkuar, te dashur, uratate t'ju jap
Sé vdékja m'aferohét, i mbétne dhé
(dy çap

DHORA (*trémbur*)

Psé flét keshtu o áte vdékjé méjtim psé ké?

KOLA

Dhé pa vdékure dua ca keshilla t'ju lé
Deghoni sé tanine ne ket ore qe jam
Flas mé zémmer moj bia fjalen te
(shenjte kam

(*Te biavé*)

Te doni çupa Dhoren dhé si motra mé te
Te jini sa te roni, te mos deghohét ze
Jashte ç'te beni brenda. Te kinî dashurî

(*Dhores*)

T'i duash dhé tî Dhore mé zémré a shkesi

(*Te biavé*)

Ndjéni fajne sé dh'une ne ket ore ja
(ndjénj
Sé zakon é barbarte sherbyér pati ndjénj
Hélmin'é saj ne zémmer, pikllimne q'ajo ka

MARGA, TASA

Névé ndyér é kémi dh'é ndjéjme prap
(babâ

KOLA

Uratate me paçi o biezat é mi
Nuk ju urronj ghe tjéter vëç kini dashurî
Dhé dhente Pérendia femiese qe vjén
Te marine pasqyre, hélmin qe nusja ndjén
Nga ky zakon i tmérur, nga ky zakon
(i lik
Te lén armiqesine te jéne ghithe miq
Tjéter ghak te mos rjédhe mja rodhi ghér
(tanî
Te rojne ghith ne paqe, te lén zakon é zi,
Te lén zakon é poshte te fe!liqur zakon
Sé pas nje shékull terre ne var ajy na çon
Msoni femien msoni! msoni qe n'végheli
Te tméréte nga ghaku nga ghak i vellajt ti
Dhé n'ju rente me qafe no-nje tjétere, jy
Ndjéni fajne sé eshte vérber pé syt é dy
Sé nuku di i mjéri vellan' é ti qe vrét
Sé ghaku qe ka rjédhur mé ghakne qe ka
(nghét !
Nje ghak kémi te terre Shqipetaret kudô
Po s'dime sé arvomi mesim si foshnja do

Pra jyvé sa te muntni pé doré sa ju dél
Péngoniji sé une ju uronj qe ne qéll
(Pi ujen. Mè ze te shuar)
Tani afrohi pake, afrohi sé do shkonj
Bashkim! bashkim te kini! véç bashkim
(ju uronj
Uratate te kini
(Bié i vdékur)

DHORA

Oh! âte ku me lé
E zéza! korba une! ûn te dergonj ne dhé
Une te kam me qafe o âte! âti jém
Ngréu dhé nje hér me fole, uratat prape
(ném
Atene tém nuk njoha, per âte bera ty
Dh'éné pa ngopur mire vdékur te shoh aty
Vdékur pé doren timé pé doren qe s' m'
(u thâ
Kur fshéhur prapa shélgut, plumbin é
(vdékjes dhâ
E zéza! korba une o une kallugré
Qe zakone sherbéva nga jéta te te ngré
O pika qe s'me bié! murtaja qe s'me ha!
Kur po te shoh te shtrire, te vdékure babâ
O zakon qe sherbéva! i fe!liqur! i zi
Barbarizm'i peshtire! zakon pé égersi

MARGA

Mos u hélmo moj moter

TASA

Ki durrim si dhé né

LIPI

Une kam fajne Dhore, tine faj nuku ké
Tine zakone s'dinjé

DHORA

O! psé te te deghonj.
Dhé zakon'é tméruar persé un te sherbonj?

LIPI

Léri keto me nj'ane sé im âte te ndjéu

DHORA

Dhé ne me ndjéu, 'nga zémra hélmin
(dhé dhémken s'kréu
O! mjér nje mie hére ajy qe pâti vra
Nje t'aferme, te dashur, nje âte, nje
(vella;

BKSH

O! mjér nje mie hére ajy qe dérdhi ghak
Pé gruajé pé djale pé foshnje a pé plak
Mallekimét é qéllit mbi kokene te tî
Do biéne dhé jéten do shkonje ne te zi
Kudô qe te barése perpara ghak do két
Dhé ndjékure pé ghaku ngadô, kudô do jèt

(Lipi dél)

MARGA

Fshi lotéte moj moter dhé ki pake durrim

DHORA

Tani véç vdékja eshte motra, qétimi tim

(Hyn Lipi mé dy shérbetore)

LIPI

Prit t'é ngréme moj Dhore

DHORA

O! jo! nuk ja u lé
Mé te dua t'mbuloném, mé te te hynj
(ne dhè

MARGA

Dhé névé zémrat tona moj moter copetoj
Po nuk bejme si tyne

DHORA

Mua zémren m'é shoj

LIPI (*luturak*)

Prit qe t'é lajme Dhore, prit t'é mvéshim (tanî
Sa pa msuare botta, sa pa ardhur. (njéri

(*Shèrbetorevè*)

Afrohi qe t'é ngrini (*motravè*) largoni (Dhoren jy

(*Marga dhè Tasa largojni mè mundimè Dhoren; shèrbetoret ngrène te vdèkurin dhè dalin,*)

DHORA

O àti im i mjére nuk do te t'shoh mé sy
Moj botta é pa bése qe jé plot hidherim
Ç'te bera un'é mjéra.

TASA

Moj moter ki durrim
Te terre do te vdésim ketu nuk ron (njéri

DHORA

O! lé te vdisté véte pa ket zakon é zi
Lé t'mos é vrisnja une

TASA

Moj motere s'ké faj
Sé, tine ghakne moré pa ditur sé pastaj
Do te benésh é bia

DHORA

É mire ç'mé kete
Kur qé njéri si mua, psé te benj kete ghe?

TASA

Per zakone moj moter

DHORA

Mos me thoni zakon
Barbarizme me thoni. Shqiptari mé ghak (ron?
Pa ghak s'mundét te ronje? esht'étuar (per ghak?
S'munt te ronje pà vrare? prandaj! vrét (pa nje shkak?
Jémi trima na thone, po ku ké trimeri?
Ketò jan égersimé, keto jan poshtesi?

TASA

Moj motere qétoju

BKSH

MARGA

Qétoju moter pak

DHORA (*si é marre*)

Ja! ja! nga-dò κthénj syte, nga-do po shekonj (ghak
Fshini ghakrat nga mûri nga shtrati (ghakne fshih

TASA (*tmèruar*)

Ç' pesové motr'é dashur?

DHORA

Gha rat atjé pa shih!

TASA (*Marges*)

Mos u marros é mjéra? çap thire Lipin, (shκo

(*Marga dèl*)

DHORA

Sheko! shekoni ghakrat! ghakrat atjé (sheko!

BKSH

Hyn Marga mé Lipin

Ç'jé dhé tî i ghakuar? mbytur ne ghak
(psé jé?

LIPI

Hajdé ner ment moj Dhore

DHORA

Mé ghak fytyren ké
Dhé une duart timé i kam mbytur mé ghak
Sé vràva pa meshire nje te varfere plak
Po prisni qe te lahém, nuk dua me ghak sos
(*Dél si é marre*)

LIPI (*bashkon duart*)

O bobo un'i mjéri!

MARGA TASA

E zéza u marros!

PÉRDIA BIÉ

BKSH

PAMJ' Ê KATERTE

(Perpara shtepise Ripavé Dhora ri nė guri q'eshte perpara dėres dykė bere çorap. Te dy femia lozen me tėj)

NUÇI

Haj te lozim mé trima

KOLA

Tì tha, me vravé fìs
Dhé une te t'mar ghakne, kur te t'biė
(tì vdis

(Dhora ngrė mė nje hėre koken)

DHORA

O! Perendi dhé foshnjat, éné pa ritur mir
Ghakne kujtojne, vrasjen, ghak per sise
(kan pir?
O Pérendi é madhé q'é kshenjteruar jé
Kete zakon te poshte psé aq forcuar ké
Ne zémrate pa ritur? édhé keto o zot
Te dine ç' eshte ghaku? te dine qe me sot
Si vriténe per ghakne, si vritén per zakon?
O Zot! mos ghak pa pire Shpiptari nuku ron
Mos do ne ghak te jéte i ritur, çilimi?

Ne ghak mos defrén zémren? mos eshte
(égersi
Per ghakrat é étuar? É madhé Pérendi!
Kréju nga zémra, kréju, kréju ket ligesi.
Ghak! émmer i tméruar, émmer i kuq si
(zjar,
Ghak dhé une nuk hodha? dhé une s' bera
(var?
O! djém, femia imé qe losni posht' atjé
Dhé mé zakon é tmérur qe qéshni pa gajlé
Ç' kerkoni njeri atrin te vrisni per zakon
Kur vrases i jyt ghyshi ketu pran jyvé ron?
Haj te me vrisni mua, haj te bini mù,
Femie qe me dhémpni, femie qe ju dù,
Lé t' thémi q' i felliqur zakon nuk eshte
(lar
Cili duhéshé çuar per véç méjé ne var?
É kush do te me vristé? cili pé djémt
(é mì?
Kola q'eshte m' i madhi? Nuçi q'eshte m'
(i ri?
O zakon ghak pa ngopur sé te vritén ç'
(te nghét?
Ghak kerkon, pa méjtuar, q' i biri t'emmen
(vrét

Mjafton te shohesh ghakne te riédhe pa (pushim
Dhé gezohésh; i ndyre, kur vritén pa (pertim ...
Dhjéte vjét kane shkuarqe kur vrava tem (vjér,
Dh' éné nuku harova ate ghak dh'ate tmér;
Si é marre therisnja, ghak shekonja kudô
Nie jave s' u qétova, ah! o Zot na shpeto,
Ghaku çfaqésh perpara i tméruar, i kéq!
Dhé sot femien témé prape ghaku i héq?
O Zot! nuk do te sosén te keqiat é mi?
Ah! kur kujtonj per ghakne me dhémp (ne mushkeri
Me copetohét zémra, nje ghe shpirtin me (thér
Nje hélmesi é madhé pa dashure me mér.

(*Si é harruar mvar koken mbi ghoksit*)

KOLA (*dykė bere nje stap si pushke*)

Bam! te plagova bjére.

NUÇI

Jo! plumbi nuk me zû

KOLA

Ri te shenonj me mire mos u tunt, ri ashtu,
Bam! tanî u plagové,

(Nuçi bië)

Ghaku tone u la

NUÇI *(i shtrire)*

Po ty kush do te t' vrase?

KOLA

No-nje tjéter pas ca

DHORA (*hélmuar*)

Te dréjte ké, pa ditur sé te dréjtene ké;
Tet vella tanî vravé, ne loder pa gajlé,
Po nésere do riti do vriti mé vertét,
Kur ndizét Shqipetari dhé Pérendine vrét.
Nuku méjton sé ç' eshte ajy prèj tî q' u vra
Sé nje nenn' i ka pjélle, sé kane nje babâ
Dhé jyvé djém te dashur, (o! shpirti m' u
(keput!
Si do ju rit mé loté, vrare ne dhè do fut

(Hyn Lipi i skuqur, femia lozen)

Ç' ké keshtu qe jé skuqur? persé vjén mé
(ndziti?

LIPI

Pa lérme sé pa dashur do vrisnja nje
(njéri

DHORA

O Pérendi! ç'me thua? ghak do benjé dhé tî?
Si, keshill é tit âti u harua tanî?
Per jéte do te rojme te mbyture ne ghak?
Nuk t'ardhi kéq per mua? per femiene pak?
Dhé persé?

LIPI

As gheséndi; u perfola mé te
Sé çoçi kisha dhene, dhé me tha s'me
(dhé ghe,
Keto fjale me ndésne, koburés dore vé
Dhé t' mos me zinin doren do t' é shtrinja
(per dhè
Po me zune ca shoke, me shtyne per ketéj
Dhé maresine timé, tanî moj grùa ndjéj
Un do hynj te ri pake te zbut ghakne q' u
(ndzé

(Lipi hyn, Dhora é shé the largohét é habitur dhé tunt kokon dykė pshéretire)

DHORA

O Pérendi! te marret, te prishurit i ndjé
Désh t' é vristé me thote; per nje fjale i (ziu
Ghak ĸerkonté te benté; Ua! sé ç' qenka (njériu,
Zémmer-qén, égersire, pa dhembje pa (meshir
I lik, pa shpirt, i poshte, i felliqur, peshtir,
Ghithe ghaĸ do te shohe, per-andaj pa (méjtim
Dérth ghakne si dérth uje dérth gakne pa (pertim
O Pérendi! po valle mallekimét na dhé?
Qe kerkon njeri-atrin te shtrinje ghall per (dhé?
O Pérendi! te shuash mos kombin tone do
Dh' i shtyn me nje te vritén? Valle dhé (tine do
Té shoç ghakne te rjédhe? dhé tine ghak (kerkon?
Dhé ty te defrén ghaku? mos ghaku te (gezon?

(persillét)

M' u thafte goja, ç'thashe.... O Pérendi! me (ndjé
Mekatéte qe bera. O Zot i mire jé
Sé fajne s' é ké tine, Shqipetari é ka
Qe s'te kujton as pake; mente ne vrasje ka

(Afrohét Péti)

PÉTI

Mirdita Zonja Dhore

DHORA

Mir' sé na ardhé Zot
Pé kohe nuk jé dukur, ç' u permbys q'ardhé (sot?

PÉTI

S' kam pasur ngé moj Zonje

DHORA

Po sot si paté ngé?

PÉTI

Dhé tanî jam ndzituar, dua Lipin, s' é pé?

BKSH

DHORA

O léré ç' i ka nghare, ne te madhé marrî
Ju ndés ghaku dhé déshté te vrase nje
(njéri
Dhé tanî i pénguar marresine kujton
Dhé ghakne qe do rithté mé lot ne sy
(méjton
Po urdherô ! haj brenda !

PÉTI (*mallenghyér*)

Thuaj te dale ca
Sé kam t' i thém dy fjale
(*Lipi qe deghoj brendazi dél mé ndzit dh' i sulét Pétit per qafé*).

LIPI

Ndjéme ! ndjéme vella !

PÉTI

Ndjème dhé mùa Lipi

LIPI

Une ndjése kerkonj
Qe pa dashur do vrisnja ty qe zémré
(shtrengonj

BKSH

PÉTI

Ketò ka zémmerimi ghaku qe kémi né,
Mé qene q'esht'i fjéshte,na shtyn pa patur
(psé
Ne vrasje

LIPI

Po né duhét te mbajme sulmin pak
Sa te mundim te mbajme doren pa bere
(ghak

PÉTI

Bésen vella te dhashe

LIPI

Dh' une bésen te nap
Vellézere te rojme *(perqafohèn se rish)*

DHORA (*mè duarte ngritur ne qéll*)

Bése te Zoti çap!
Dhé dhente Pérendia qe si bejne keta
Te bejne ghithe botta.

NUÇI *(Koles)*

Dhé tine bésen na!

PÉRDIA BIÉ

FUNT

(24) 12) 1904

BKSH

BKSH

PAJTIMTARET ZOTERINJ

Thironi	*gr*	*100*
A. Z. Çajup	»	*30*
Tas Skendo	»	*30*
Dr Jean Tsamis	»	*20*
P. Pluska	»	*20*
Spirpo Dinė	»	*10*
Kostantin N. Konstantinu	»	*10*
Nip'i Dėrvishit	»	*10*
F. H. D. di Calabria	»	*10*
Nje Shqipetar	»	*10*
Ahilėa Vasiliu	»	*10*
Gropa Gurit	»	*5*
Vanni Annanėzi	»	*5*
Hristo Kumanaqi	»	*5*
J. Noçika	»	*5*
Th. Noçika	»	*5*
Ilo Bėllo	»	*5*
Kosti Dxumari	»	*5*
Jorhgi Tolė	»	*5*
Vanni Karaméta	»	*5*
Haralambi D. Skendo	»	*5*
Thémistokli Aviérino	»	*5*
Naum Didaku	»	*5*
Hristo Pétridi	»	*5*
Nikola Ekonomo	»	*5*
Nje Shqipetar	»	*5*
Kosta N. Dossi	»	*5*
K! K!	»	*5*
Dimitri Th. Zado	»	*5*

I ghatjėtojme te terre si dhė Zotin N. D. i cili pati mirėsine te na huanje 5 L. per shtypjen.

L. M.

PKSH